

"BREZI PLUS"

**Botim periodik
Letrare
Shoqërore e
Kulturore**

**Boton:
Albanika ET- Tetovë**

**Redaktor përgjegjës:
Mimoza Jahiu**

**Redaksia:
Ilber Jaiu
Remzi Emshiu
Ylber Jahiu
Alba Jahiu**

**Adresa e redaksisë:
Rr. Bllagoja Toska Bllok 82, CA-
nr6 – Tetovë
Contact. 072 639 105**

e-mail: albanika19@hotmail.com

**Publikimi:
[https://top24.mk/category/libra-
-revista/](https://top24.mk/category/libra-revista/)**

Prill-Qershor, 2021

Fjala e redakësisë

Revista letrare "Brezi Plus" është përpjekje për t'u rikthyer mes rinisë, intelektualve dhe bashkëvendësve tanë një pjesë të vlerave dhe pasurive kulturore shqiptare të cilat ngadalë po shuhen dhe harohen. Nga ky këndvështrim në këtë numër redaksia e "Brezi Plus" në vigjilje të ditës së Mësuesit 7 Marsi e cila është muajn e ardhshëm ju sjell materiale për figura të shquara kombëtare si pof.dr.Remzi Nesimin, Inva Mula, Isak Njutoni etj. Përkujtimi i veprave të rilindësve tonë në këtë revistë është tendencë për të evidentuar dokumentuar veprën e tzre me të vetmin qëllim që lexuesi sot të ketë informacion profesional dhe të dokumentuar.

Revista "Brezi Plus" gjatë botimit të numrave, në vazhdimësi rëndësi të veçantë do t'ju kushtoj figurave të shquara kombëtare duke sjellur dokumente dhe materiale të rëndësishme të pa publikuara deri më sot në revista të tjera.

Duke u munduar të kontribuojmë në pasurimin e tregut letrarë besojmë që kjo revistë do të plotësoj hapsirën e munguar në vite në vendin tonë.

Me respekt! Redaksia e "Brezi Plus"

Remzi Nesimi në kongresin e drejtshkrimit 1972**JETA DHE VEPRA E REMZI NESIMIT**

46 vjet më parë, prej 20 deri më 25 nëntor 1972, u mbajt në Tiranë me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë dhe me praninë e 87 delegatëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshët e Italisë.

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, padyshim ngjarja më e rëndësishme e shekullit XX për gjuhën tonë kombëtare pas Kongesit të Manastirit që miratoi alfabetin.

Me Kongesin e Drejtshkrimit, gjuha shqipe mbërriti të ketë standardet e një gjuhe moderne, të unifikuar në normën drejtshkrimore,

ashtu sikundër duhet të jetë në fakt gjuha si elementi bazë e padyshim më i rëndësishëm i përveçimit të identitetit tonë kombëtar!

Prandaj, shteti shqiptar në rradhë të parë e mandej e gjithë bota kulturore e akademike shqiptare, por edhe i gjithë kombi ynë do të duhej të ndërtonte në këtë

përvjetor, veprën e paçmuar për nga dimensionet e pesha patriotike, kulturore e shkencore të të gjithë delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të cilët ishin përfaqësuesit më të shquar të elitës shkencore e akademike nga gjuhësia, letërsia, historia e mësimdhënia!

Mirëpo, autoritetet shtetërore dhe shkencore të Shqipërisë zgjodhën ta vrasin këtë ngjarje të madhe për kulturën dhe historinë tonë kombëtare me heshtje, më së pari si dëshmi e injorancës së tyre, që i komplekson deri në këtë shkallë, sa të na dëshmojnë se nuk kanë guximin as të flasin e jo më pastaj të ndër marrin hapa për të realizuar nisma

atdhetare e shkencore si Kongesi i Drejtshkrimit!

E megjithatë, pavarësisht injorancës dhe keqdashjes, pavarësisht kompleksit dhe frikës që ajo sjell e që na e dëshmojnë udhëheqësit tanë udhëmbyllës, siç është edhe rasti i qëndrimit të tyre ndaj Kongesit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në 46-vjetorin e mbajtjes së tij, kodifikimi dhe unifikimi i normës drejtshkrimore të gjuhës shqipe, mbetet një kontribut i vyer atdhetar në rradhë të parë, e mandej edhe shkencor e intelektual jo vetëm për gjuhën tonë si elementi i parë e më i rëndësishëm i identitetit dhe unitetit kombëtar,

por edhe me gjerë për shkencat albanologjike, për historinë e kulturën shqiptare!

Ndaj, për jetë nderim e mirënjohje të gjithë atyre që kontribuan 46-vjet më parë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të gjuhës tonë për të cilën Ndre Mjedja pati shkruar:



***“Geg’ e tosk’ malci, jallia,
Jan’ një komb, me u da s’duron,
Fund e maj një a Shqypnia,
E një gjuh’ t’gjith na bashkon!”***

Sipas kësaj filozofie të shprehur me aq largpamësi nga Mjedja, vlerësimi i Kongresit të Drejtshkrimit me realizëm e objektivitet për çfarë kontribuoi në zhvillimin e gjuhës shqipe, e bën të domosdosshme një nismë të atyre përmasave, për të reflektuar gjithë zhvillimet që ka pësuar gjuha jonë e proceset nëpër të cilat ajo ka kaluar në keta 46 vjet, prej Kongresit.

Eshtë një sfidë që i takon në rradhë të parë bashkësisë së punëtorëve të gjuhës shqipe, por edhe të gjithë shkencëtarëve e intelektualëve që dinë të kuptojnë rëndësinë që ka përmbushja e sfidave të tilla të mëdha e me interes kombëtar. Synimi i mbledhjes së Kongresit ishte përcaktimi i parimeve dhe drejtimeve kryesore për hartimin e rregullave të drejtshkrimit, për të pasur një gjuhë letrare të njësuar kombëtare. Ky Kongres, si forumi më i lartë shkencor, analizoi e diskutoi gjerësisht parimet themelore, çështjet e

përgjithshme dhe shumë zgjidhje të veçanta të drejtshkrimit të shqipes, si edhe probleme të tjera teorike e praktike, që kanë të bëjnë me normën letrare në përgjithësi.

Në kongresin e drejtshkrimit nga Tetova do të udhëtonte Prof.dr. Remzi Nesimi.

Prof.dr. Remzi Nesimi lindi në fshatin Odri të Tetovës, më vitin 1933. Shkollën e mesme e kreu në Tetovë, të lartën dhe studimet pasuniversitare në Universitetin e Beogradit, kurse doktoraturën e mbrojti në Universitetin e Prishtinës. Menjëherë pas kryerjes së studimeve, një vit punoi në redaksinë e botimeve “Rilindja” në Prishtinë si lektor – redaktor. Në këtë cilësi ka punuar edhe në redaksinë e “Flakës së vëllazërimit” deri në tetor të vitit 1962, kur zgjidhet lektor i gjuhës shqipe në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, ku punoi plot dy vjet dhe më pas (1962-1964), pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike në Shkup (1964-1975), profesor në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Universitetin e Shkupit (1975-1999). Po kështu, për disa vjet profesori mbajti edhe leksione në lëndët e gjuhës shqipe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Profesor Remziu nga karakteri ishte i sinqertë, bujar, besnik, zemërgjerë, human, arsimdashës, largpamës, patriot. Me një vetëdije të lartë kombëtare, i shtyrë nga dëshira e flaktë për arsimimin e shqiptarëve, për disa vite rresht, ligjëroi në Universitetin (siç e quanin jolegal) të Tetovës edhe përskaaj rreziqeve e pasojave që mund të kishte asokohe. Veprimtaria e prof. Remziut është e pasur dhe e shumëllojshme: lektor – redaktor i një numri të madh (afër 30) veprash të ndryshme letrare, shkencore, kulturore si dhe i shumë teksteve shkollore të

botuara në Maqedoni e Kosovë. Pothuajse katër dekada ligjëroi gjuhën shqipe në arsimin e lartë. Për nevojat e shkollimit fillor dhe të mesëm në Maqedoni hartoi disa gramatika. Veprimtaria profesionale e profesor Remziut pasqyrohet edhe në mbi 100 artikuj, studime, shqipërime (mbi 20) e monografi me vlerë shkencore. Ka qenë anëtar i Komitetit Republikan të Arsimit e të Kulturës, anëtar i Pleqësisë Republikane Pedagogjike të Maqedonisë, anëtar i kolegjiut të Redaksisë së Jehonës (përgjegjës dhe redaktor i rubrikës



së gjuhësisë), anëtar i Këshillit Redaktues të Teksteve Shkollore në gjuhën shqipe në Shtëpinë Botuese “Prosvetno Dello”, anëtar i Komisionit Republikan për përsosje kërkimoreshkencore të kuadrit, anëtar i Pleqësisë për përkujdesjen dhe zhvillimin e gjuhës letrare në Radio-Televizionin e Maqedonisë, anëtar i Kolegjiut redaktues i revistës shkencore “Gjurmime albanologjike” – Prishtinë etj.

Prof. dr. Remzi Nesimi është nderuar me disa mirënjohje, diploma e medalje.⁴ Profesor Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i zellshëm i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediat e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja, në veçanti nga elementet sllave.

Dy vite para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, përkatësisht që më 1970, në faqet e gazetës “Flaka e vëllazërimit” që botohej në Shkup, në shtatë numra të njëpasnjëshëm, paraqet dhe arsyeton rëndësinë

dhe nevojën e konstituimit të një gjuhe të përbashkët letrare dhe standardizimin e saj. Si kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Arsimitarëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Maqedonisë ishte njëri ndër organizatorët kryesorë për përgatitjen e Konferencës Shkencore për shënimin e 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit dhe njëri ndër tre bashkëkryetarët e Konferencës. Takimi, në të cilin morën pjesë gjuhëtarët më në zë të Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë, u mbajt në Tetovë në qershor të vitit 1992. Nga shkrimet e prof. Remziut mund të nxirret porosia se jemi një komb, prandaj duhet të kemi një gjuhë të përbashkët. Ai vazhdimisht ka shkruar e folur për pastrimin, pasurimin dhe përgjithësisht, për kulturën e gjuhës në Maqedoni e më gjerë.

Në Kongresin e Drejtshkrimit ai tha : *“Sikurse në qendra të ndryshme – në Stamboll, në Bukuresht etj., ashtu edhe në Maqedoni, janë bërë mjaft përpjekje për zhvillimin e shqipes letrare. Sidomos një vend të rëndësishëm në këtë proces, përkatësisht në krijimin e alfabetit përfundimtar të shqipes, zë edhe Manastiri, i cili prej kohësh ka qenë qendër e njohur kulture në Gadishullin Ballkanik. Një vit pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit ...”* Shoqëria Botuese Letrare e po këtij qyteti botoi edhe Abetaren e njëjës prej pedagogëve të para të arsimit kombëtar, Parashqevi Qiriazi, dhe jo vetëm kaq. Në këtë vend e në qendrat e tjera vepruan edhe mjaft shoqëri kulturore, u botuan gazeta, siç janë *“Kosova”* (1908) e *“Shkupi”*, që dilnin në Shkup. Por për shkak të rrethanave të njohura historike, për më se 30 vjet, sikurse në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, u shua çdo gjurmë e kulturës kombëtare. Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, krahas me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe prej fillores e gjer në shkollat e larta, filloi tek ne edhe veprimtaria e gjerë botuese në gjuhën shqipe”.

Më se gjysmë shekulli, përkatësisht që nga vitet “60 të shekullit të kaluar, me përkushtim e vetëmohim ka punuar për ngritjen e përgjithshme arsimore e kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë, për të lëvruar, kodifikuar dhe përpunuar shqipen standarde.

Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142. 45 thënien e

profesor Aleksandër Xhuvanit: *“Njësia e gjuhës është njësia e kombit”*. Në këta rreshta me vlerë na njofton për rrjedhën e zhvillimit të shqipes letrare në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore e më pas. Ai me të drejtë konstaton se: *“Që në vitet e para pas çlirimit të ne u krijuan dy qendra kulture: Prishtina në Kosovë dhe Shkupi në Maqedoni. Në të dyja këto qendra u zhvillua edhe një veprimtari botuese. Përveç shumë teksteve shkollore, në Shkup filloi të dalë “Flaka e vëllazërimit”, në Prishtinë “Rilindja” e më vonë edhe revista e botime të tjera. Ndonëse në këto dy qendra gjer më 1968 u përdor gegërishtja letrare. Në pikëpamje ortografike kjo gegërishte nuk ka qenë krejtësisht e njëjtë”*.

Në Maqedoni si në shkolla ashtu edhe në teatër, në shtyp e në radio edhe para vendosjes



së një gjuhe letrare të njësuar është përdorur gjuha dhe ortografia e variantit letrar verior të mesëm. ...“Procesin e njësimimit të gjuhës së shkruar sipas variantit letrar të mesëm e ndihmuan mjaft edhe një numër i madh arsimtarësh ish-normalistët të Elbasanit, si dhe të krahinave të tjera jugore të Shqipërisë që shërbyen vite me radhë në qendra të ndryshme të Maqedonisë – në Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Strugë etj.

Për shërbimet e tyre të mëdha të gjithë këta punonjës të zellshëm meritojnë respektin dhe mirënjohjen tonë të thellë... Qysh kur filloi të përdoret gjuha letrare, në Maqedoni kemi pasur një ecuri paralele si me drejtshkrimin, ashtu edhe me gjuhën standarde të përdorur në vendin amë. Në vitet e para u përdor drejtshkrimi që ishte përdorur në tekstet gramatikore të profesor A. Xhuvanit, pastaj ortografia që u botua më 1948, drejtshkrimi i vitit 1951 dhe më në fund “Ortografia e gjuhës shqipe” e vitit 1956... Pas botimit të

“Rregullave të drejtshkrimit të shqipes”, disa muaj para se të mbahej Konsulta gjuhësore në Prishtinë, “Flaka e vëllazërimit” kishte filluar të dalë në gjuhën e sotme letrare dhe me këtë u realizua edhe një e vërtetë shkencore, u realizuan dëshirat qindvjeçare...” Qëndrimin e delegatëve të Kongresit si edhe të të gjithë shqiptarëve të Maqedonisë për njësimin e shqipes, që atëherë, Nesimi e shpreh haptas se: “Parimi themelor i intelektualëve tanë gjithnjë ka qenë që të ndiqet ajo ortografi dhe bile edhe ajo gjuhë që përdoret në vendin amë”. Me pranimin e vendimeve të Kongresit e më pas me zbatimin si dhe me përhapjen e shqipes standarde, këta intelektualë nga Maqedonia kanë dhënë ndihmesë të madhe në ruajtjen e njësisë gjuhësore si dhe në ngritjen dhe ruajtjen e identitetit tonë kombëtar. Falë veprimtarisë së atdhetarëve tanë, ne i kemi bërë ballë politikës asimiluese. Pandaj, sot jemi mbledhur tok, krahinash e visesh të ndryshme shqiptare, toskë e gegë: nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova Lindore, diaspora e nga gjithë bota të shënojmë, të festojmë e të madhërojmë mbijetesën tonë gjuhësore e rrjedhimisht edhe mbijetesën kombëtare. Vetëm kështu të bashkuar do të hapërojmë drejt botës së qytetëruar e do të shënojmë edhe shumë suksese në qindvjetorë të ardhshëm.

Prof.Dr Remzi Nesimi u nda nga jeta më 03.Shkurt 2018.Varimi i professor Nesimit u bë në vendlindjen e tij në fshatin Odër të Tetovës, Komuna e Tearcës.

Më poshtë disa nga ata që kujtuan prof.dr. Remzi Nesimin...

Salajdin Salihu

Një lajm i trishtë!

Iku në amshim personaliteti i madh i shkencës shqiptare, prof. Remzi Nesimi.

Iku në amshim Njeriu, Studiuesi, Pedagogu model, delegati i Kongresit të Drejtshkrimit dhe autori i veprave të çmuara nga gjuhësia.

Jam me fat që e kam njohur. Që sot, ndonëse janë çaste pikëllimi, duhet të mendojmë e të angazhohemi bashkërisht për botimin e veprës së plotë të Profesorit, që është pasuri kombëtare.

Lamtumirë Profesor i dashur dhe faleminderit për kontributin e dhënë për kulturën tonë!

Fatmir Sulejmani

Iku në përjetësi dhe Remzi Nesimi.

Pusho në paqë PROFESORI ynë i dashur!

Nijazi Muhamedi

SHQIPJA NE DITE ZIE

Profesor REMZI NESIMI ishte rilindesi i përshpirtshëm që një jetë,me punë,studime e dashuri ia kushtoi shqipes, kësaj tapie shpirtërore të përhershmerisë së identitetit shqiptar.

Jetën e deshi për t'i dhënë gjuhës dhe Tetovës forcë e denjësi gjallnimi të përshqiptarshëm. Gjuha dhe Tetova sot ra në zi.

I përkulemi thellësisht jetës dhe vepres së tij të përshpirtshme për gjuhën dhe atninë. I ndritur qoftë përjetësisht dhe ndër brezat shqiptarë që vijnë kujtimi mbi veprën e tij.



Bardhyl Zaimi

Isha student i tij. ” Gjuha mësohet nga gramatika, por edhe nga leximet”, kështu tha profesori i përshpirtshëm, Remzi Nesimi, pas provimit të morfologjisë.Profesor kalibër, njeri i jashtëzakonshëm, një shkencëtar par excellence, një shqiptar i përndritur dhe reflektues. Do ta kujtojmë përgjithnjë...

Inva Mula – Këngëtarja që prezantoi shqiptarët

INVA MULA YLLI NDRIÇOI SHQIPTARËT KUDO QË NDODHEN

Megjithese Inva është tashmë një personalitet me dimensione shumë më të mëdha se vetëm ato shqiptare, që ka prekur skenat më të famshme botërore dhe ka njohur personalitete nga më të famshmet në mbarë botën, Inva ka mbetur e thjeshtë dhe shumë njerëzore, një kënaqësi e vërtetë për të biseduar dhe për ta admiruar edhe më tepër nga afër.

Inva Mula është një emër i njohur jo vetëm në mbarë viset shqiptare, por edhe në botë. E lindur në Tiranë në një familje artistësh, Nina dhe Avni Mula, Inva filloi të marrë mësim pianoje që e vogël. Koncertin i saj të parë e dha kur ishte 5 vjeç. Deri më sot Inva ka marrë shume cmime si edhe dashurinë e mbarëpublikut, si shqiptar ashtu edhe ndërkombëtar, dhe këngët e saj janë bere moto e mbarë gjeneratave.

Në moshën 16 vjeçare ajo merr mësim nga e ëma e saj, zonja Nina Mula që fatkeqësisht është ndarë nga ne. Më vonë ajo diplomohet si soprano në Akademinë e Arteve në Tiranë ku interpreton Violetën e Traviates, performancë kjo që do të përsëritet disa herë në rolet e mëpasshme. Ky rol i hap dyert e Teatrit te Operes në Tiranë ku ajo këndon për 5 vjet me rradhë si soliste. Aty ajo interpreton rolet e Rozines tek Berberi i Seviljes, Mimi tek Boheme, Xhilda tek Rigoletto, si edhe këndon në opera të kompozitorëve shqiptarë.

Në këtë periudhë ajo fiton konkursin « Tefta Tashko Koco » dhe shpallet si këngëtarja më e mirë e operës për vitin 1987. Që këtu ajo fillon të shfaqet nëpër koncerte ndërkombëtare, fiton çmimin Zhorzh Enesko ne 1990, më pas Madame Butterfly në Barcelonë.

Që nga viti 1992 ajo zhvendoset në Francë, ku edhe pjesërisht jeton, triumfon në 1993 në konkursin « Placido Domingo » dhe që aty fillon një bashkëpunim të ngushtë me maestron e madh. Pikërisht këtu fillon karriera e saj internacionale, fillimisht në operën e Avignon, pastaj Los Angeles, Bonn, Washington, Chicago e New York..

Bashkëpunime të mëtejshme me emra të mëdha në fushën operistike si me baritonin Leo Nucci apo maestron Ricardo Muti ne teatrin e la Scales ne Milano i hapin rrugën suksesit të saj të mëtejshëm në Itali. Ajo ftohet të këndojë Violetën për hapjen e teatrit

Arcimoldo në Milano, sukses ky që i sjell angazhime të tjera në Itali.

Pas turneve të shumta nëpër botë si dhe promovimit te CD-së së re të saj në Tiranë, Prishtinë e Shkup,



sopranoja e famshme shqiptare ndodhet momentalisht ne Zyrih. Mes obligimeve të shumta familjare dhe profesionale, pasi po luan rolin kryesor në „Boheme“ në operën e Zyrihut, Inva e gjen kohën dhe shpreh dëshirën të jetë e pranishme në një mbremje për shqiptarët e Zvicrës. Sopranoja e famshme sapo ka regjistruar albumin e dytë me këngë në shqip dhe nuk është një rastësi që e ka quajtur pikërisht „Për ty atdhe“. Ky album që përmban 12 këngë ka lindur si iniciative e këngëtares pikërisht për 100 vjetorin e Pavarësisë dhe është perçuar në të gjitha trevat shqiptare. Janë këngët më të njohura të kënduara ne vite, këngë të cilat duhet të përcillen në të gjithë brezat e ardhshëm si pasuri e çmuar e kombit tonë. Tituj si „Rrjedh në këngë e ligjerime“, „Për mëmëdhenë“, „Himni i flamurit“, „Agimet shqiptare“ apo „Dua më shumë

Shqiperinë“ janë balsam për veshin e çdo bashkëatdhetari, janë një rikthim në nostalgjinë e kohëve të hershme.

Së bashku me bashkëshortin e saj Etem Ramadani ata kanë thirrur në jetë edhe fondacionin e quajtur « Hi Classic », për të ndihmuar talentet e reja në fushën e artit.

Por Inva megjithëse jeton jashtë shtetit është më e pranishme se kurrë pranë shqiptarëve të kudondodhur në botë.

Kjo ishte edhe arsyeja që Inva ishte me ne në bibliotekën interkulturore Pestalozzi Hardau, për të kaluar së bashku një mbrëmje artistike, ku dëgjuam një pjesë të këtyre këngëve si dhe patëm mundësinë e rrallë ta përjetojmë Invën live.

Suela Jorgaqi: E dashur Inva, ishte një kënaqësi e madhe për mua që ishe e ftuara ime këtu në bibliotekën që unë drejtoj, në të cilën kemi edhe shumë libra shqip...

Inva Mula: Në radhë të parë Suela të falënderoj për mikpritjen tënde. Takimi ynë i parë ishte i shpejtë, por që në fjalitë e para të bisedës sonë ne ramë dakort të organizonim këtë aktivitet dhe kjo falë gadishmërisë dhe pozitivitetit tënd.

Suela Jorgaqi: Shumë faleminderit, Inva, kënaqësia ishte e gjitha e imja... Po si dhe kur të lindi ideja për këtë CD? Ti ke qënë në të gjithë trevat shqiptare për ta sjellë sa më pranë shqiptarëve këtë pasuri tejet të çmuar. Si je prituri?

Inva Mula: Ideja e këtij disku lindi spontanisht në provat që unë zhvilloj me pianistin e talentuar Genc Tukiçi në Paris.

Ne gjithnjë në koncertet tona interpretojmë perla të muzikës shqiptare, por ideja për t'i ripunuar këto këngë, riorkestruar tashmë për orkestër sinfonike, kërkonte një punë të madhe, në radhë të parë nga Genc Tukiçi, që është edhe orkestruesi i këngëve si dhe më pas nga puna pasionante e dirigjentit Bujar Llapi. Paraqitja e parë ka qënë në Tiranë, pasuar me Prishtinën dhe ky trekëndësh u mbyll me një koncert të mrekullueshëm në Shkup. Me prezantimin e CD-së në Zyrih fillon dhe një tur i gjatë, pasi në të gjithë shtetet ku unë

udhëtoj për performancat e mia skenike dua t'i le bashkombësve të mi tingujt e muzikës shqiptare, këngët më të bukura për atdheun, pasi e di që secili nga ne ka nevojë shpirtërore për to dhe do t'ua përcjellë këtë pasuri fëmijëve të tyre.

Suela Jorgaqi: Në Tiranë të rinjtë shpesh dëgjojnë muzikë të huaj, është ky një fenomen i zakonshëm apo ka më shumë nevojë për rikthim në rrënjët shqiptare?

Inva Mula: Të rinjtë në përgjithësi kanë tendencë të dëgjojnë muzikë të huaj, ne nuk mund të imponojmë zgjedhjet e tyre, por kemi për detyrë të prezantojmë muzikë të mirë shqiptare dhe sidomos të rifreskojmë perlat e muzikës që janë shkruar në vite.



Majkëll Hart

ISAK NJUTNI NJERIU I DYTË MË ME NDIKIM NE HISTORI

Isak Njutni shkencëtari më i madh dhe më me ndikim i të gjitha kohëve, u lind në Vulstrop, Angli, më 25 dhjetor 1642, po atë vit kur vdiq Galileo Galilei. Ashtu si Muhammedi edhe ky u lind pas vdekjes së të atit.

Qysh në fëmijëri Isaku shfaqte interesim për mekanikën dhe ishte mjaft i gjendshëm e i shkathët. Edhe pse femijë i mençur, në shkollë që i pakujdesshëm dhe nuk la ndonjë përshtypje të veçantë.

Kur u bë më i rritur, nëna e tij e çregjistroi nga shkolla, me

shpresë, se në bujqësi do të jetë më i suksesshëm.

Fatmirësisht u zbulua se ai kishte prirje për punë të tjera, kështu që në moshën 18 vjeçare u regjisirua në Universitetin e Kembrixhit.

Atje shumë shpejt mësoi shkencën e atëherëshme dhe matematikën, dhe pas një kohe të shkurtër i filloi hulumtimet e veta. Në moshën 21-27 vjeçare, Njutni i vuri bazat e teorive shkencore, të cilat më vonë mundësuan ndryshimet rrënjësore në botë.

Mesi i shekullit XVII është kohë e ngritjes së paparë shkencore. Zbulimi i teleskopit në fillim të shekullit, në mënyrë rrënjësore i ndryshoi hulumtimet astronomike. Filozofi anule, Frensis Bekon dhe dijetari francez Rene Dekart u apelonin shkencëtarëve të mbarë Evropës që më të mos mbështeteshin në autoritetin e Aristotelit, por të fillojnë me hulumtime dhe gjurmime vetjake.

Njutni madhështor në praktikë e arriti atë për të cilën angazhoheshin Bekoni dhe Dekarti. Studimet e tij në astronomi dhe shfrytëzimi i teleskopit të posazbuluar, kushtëzojnë ndryshime rrënjësore në këtë shkencë, ndërkaq eksperimentet në mekanikë sollën deri te formulimi i Ligjit të parë (të Njutnit) për lëvizjen. Shkencëtarë të tjerë si Uilijam Harvi

(zbuloi qarkullimin e gjakut) dhe Johanes Kepler (formuloi ligjet e lëvizjes së planetëve rreth Diellit), gjithashtu futën informacione thelbësore në rrethet shkencore.

Megjithatë shkenca e mirëfilltë edhe më tej ishte preokupim i njerëzve, të cilët u morën me punët mendore andaj edhe nuk ka pasur fakte për pohimet e Frensis Bekonit se e shkruar në teknikë, ajo rrënjësisht mund t'i ndryshojë kushtet reale të jetës së njerëzve.

Edhe pse Koperniku dhe Galileu kundërshtuan disa nga botëkuptimet e gabuara të shkencës së


lashtë duke kontribuar me këtë në të kuptuarit më të mirë të Gjithësisë, akoma nuk ishin të formuluar parimet, të cilat të gjitha faktet do t'i sintetizonin në një teori të veçantë me qëllim që

parashikimet shkencore të bëhen të mundshme e reale.

Isak Njutni është ai, i cili e përpiloi atë teori të veçantë dhe e orientoi shkencën moderne drejt rrugës, të cilën ajo e ndjek që atëherë e sot e kësaj dite.

Njutni asnjëherë nuk ka pasur ndonjë dëshirë të veçantë që t'i shpallë rezultatet e arritura, edhe pse në vitin 1669 tanimë i formuoi idetë themelore të zbulimeve të tij, një numër i madh i teorive janë bërë të njohura tepër vonë. Zbulimi i parë i shpallur i tij është punimi themelvenës për natyrën e dritës. Pas një varg eksperimentesh të ndërlikuara Njutni zbuloi se drita e thjeshtë e bardhë është e përbërë nga të gjitha ngjyrat e ylberit.

Krahas kësaj ai me kujdes të madh i studionte ligjet e reflektimit dhe të përthyerjes së dritës. Kështu në vitin 1668 ai e krijoi dhe praktikisht e ndërtoi teleskopin e parë me pasqyrë, teleskopin reflektues, i cili edhe sot përdoret në më shumë observatoriume astronomike.



Në moshën 29 vjeçare, Njutni, para Shoqërisë mbretërore britanike i prezantoi këto zbulime së bashku me eksperimentet tjera të tij në lëmin e optikës. Vetëm këto zbulime janë të mjaftueshme që t'i sigurojnë vend në këtë listë ranguese, por janë të shumta edhe të arriturat e tij në matematikën e mirëfilltë dhe në mekanikë.

Kontributi i tij kryesor në matematikë është zbulimi i llogaritjeve integrale, të cilat arriti t'i zbulojë që në moshën 23-24 vjeçare. Kjo arritje më e rëndësishme në matematikën moderne s'është vetëm kokërr nga e cila lindet një pjesë e madhe e teorisë bashkëkohore matematikore, por edhe instrumeti i jashtëzakonshëm pa ekzistimin e të cilit përparimi i mëtejshëm i shkencës moderne do të ishte i pamundshëm. Edhe po qe se të mos zbulonte asgjë tjetër, pos llogaritjeve integrale, ajo do t'i siguronte Njutnit njërin nga pozitat parësore në këtë vepër.

Megjithatë, sukseset më të rëndësishme të Njutnit janë në lëmin e mekanikës-shkencë, e cila e sqaron lëvizjen e trupave fizikë. Galileu zbuloi ligjin e parë të lëvizjes me të cilin sqarohet lëvizja e trupave nën ndikimin e forcave të jashtme. Në praktikë, është e qartë se të gjitha trupat u nënshtrohen ndikimeve, por, çështje thelbësore në mekanikë është se si lëvizin trupat nën ndikimin e forcave të jashtme.

Këto problem Njutni e zgjidhi me Ligjin e tij të dytë të lëvizjes, i cili me të drejtë konsiderohet si bazament në fizikën klasike. Ligji i dytë (formula matematikore e të cilit është $F = ma$) thotë: rritja e shpejtësisë së një trupi është e barabartë me forcën ndikuese ndaj tij e pjesëtuar me masën e tij.

Më vonë këtyre dy ligjeve Njutni ua ndajsthoi edhe Ligjin e tretë famoz për lëvizjen (ai thotë: çdo ndikim apo forcë fizike ka edhe kundërndikimin e barabartë në kahje të kundërt) dhe Ligjin më të njohur për gravitacionin kozmik. Këto katër ligje, marrë në tërësi, paraqesin një sistem të veçantë nëpërmjet të të cilit praktikisht të gjitha sistemet mekanike makroskopike-prej lëvizjes së lavjerësit e deri te lëvizja e planeteve nëpër orbitat rreth Diellit mund të hulumtohen e të parashihen veprimet e tyre. Njutni jo vetëm që i formuloi ligjet themelore të mekanikës, por

duke i shfrytëzuar llogaritjet integrale, personalisht tregoi se si mund të aplikohen ato në zgjidhjen e problemeve aktuale.

Ligjet e Njutnit shfrytëzohen në zgjidhjen e një rrethi të gjerë të problemeve shkencore e teknike.

Derisa ai ishte gjallë, këto ligje aplikim më evident kishin në astronomi. Edhe këtu Njutni fitoi një vend të lartë. Në vitin 1687 ai botoi veprën e rëndësishme "Parimet matematikore të filozofisë së natyrës" (shkurtime të njohur si "PRINCIPIA"), në të cilën janë të eksplikuara Ligji i gravitacionit dhe ligjet e lëvizjes. Ai tregoi se si duhet të aplikohen ato ligje që të caktohet me saktësi të madhe lëvizja e planeteve rreth Diellit. Detyrën themelore të astronomisë dinamike gjegejshme me saktësi të



parashihen pozitat dhe lëvizjet e yjeve dhe planeteve Njutni e zgjidhi në mënyrë të shkëlqyeshme, vetëm me një lëvizje. Pikërisht për këtë pothuajse të gjithë e konsiderojnë si më të madhin ndër astronomët. Atëherë çfarë është vlerësimi ynë për rëndësinë shkencore të Njutnit? Gjatë shqyrtimit të regjistrit të çfarëdo qoftë enciklopedie shkencore, hasim në më shumë udhëzime (dytri herë më shumë) nga njësitë për Njutnin dhe për ligjet e zbulimet e tij, se sa për cilindo shkencëtar tjetër.

Përveç kësaj duhet t'u kushtohet kujdes edhe thëniet e shkencëtarëve të tjerë për Njutnin! Shkencëtari gjerman Gotfrid Lajbnic (1646-1716), i cili nuk ishte mik i Njutnit, dhe me të cilin ka pasur polemika të rrepta shkruan: "Nëse e marrim matematikën që nga themelimi i saj e deri në kohën e Njutnit, pjesa më e madhe e saj është vepër e Njutnit!"

Shkencëtari i madh francez Pjer Laplas (1749-1827) ka shkruar: "Principia i kapërcen të gjitha veprat tjera të gjenit njerëzor".

Matematikani francez Lui Lagranzh (1736-1813) shpeshherë përsëriste se Njutni është gjeniu më i madh që ka pasur bota, ndërsa Ernest Maks (1838-1916) fizikan austriak, në vitin 1901 shkroi: "Gjithçka që është arritur pas kohës së tij është përpunim deduktiv formal matematikor i mekanikës në bazë të ligjeve të Njutnit". Kontributi i madh i Njutnit eksplikohet me këtë: ai ndërlihet me shumicën e fakteve dhe ligjeve, të cilat mund të sqarojnë disa dukuri, por nuk janë në gjendje të parashohin diçka; shkencëtari na la sistemin e veçantë të ligjeve që mund të aplikohen te një numër i madh i dukurive fizike dhe të shërbejë nëpër parashikime të sakta. Në këtë trajtesë të shkurtër nuk është e

mundshme që të shpjegohen hollësisht të gjitha zbulimet e Njutnit; prandaj shumica e tyre do të mbeten të papërmendura ndonëse i përkasin sukseseve serioze.

Njutni dha kontribut solid edhe në termodinamikë (shkenca për nxehtësinë) si dhe në akustikë (shkenca për zërin); ai formuloi parimin eksklusivisht të rëndësishëm fizik të veprimit të forcës dhe aksion reaksionit; e përgjithësoi binomin (binomi i Njutnit) në matematikë, zbuloi rendin e pakufishëm të binomit; e dha sqarimin e parë të bindshëm për prejardhjen e yjeve etj. Kështu mund të themi se Njutni gjithsesi është shkencëtari më i madh dhe më me ndikim i të gjitha kohëve, por edhe të shtrojmë pyetjen përse ai këtu qëndron më lartë në krahasim me personalitetet e tjera të rëndësishme politike siç janë Leka i Madh apo Xhorxh Uashingtoni dhe një hap më parë nga prijatarët e njohur religjiozë Jezu Krishti dhe Buda. Qëndrimi ynë është se edhe përkundër rëndësisë së madhe të ndryshimeve politike, njerëzit e botës pesë shekuj pas vdekjes së

Lekës së Madh kanë jetuar njësoj sikur edhe stërgjyshërit e tyre që kanë jetuar pesë shekuj para tij.

Sipas logjikës së njëjtë jeta e njerëzve 1500 vjet para Krishtit ka qenë e njëjte sikurse jeta e njerëzve që kanë jetuar 1500 vjet pas Krishtit. Por në 500 vitet e fundit që nga paraqitja e shkencës bashkëkohore, jeta e përditshme e shumë njerëzve rrënjësisht ka ndryshuar.

Ne vishemi më ndryshe, ushqehemi me ushqim tjetër, punojmë në mënyra të tjera dhe kohën e lirë e shfrytëzojmë shumë më ndryshe sesa njerëzit e pesë apo më shumë shekujve të mëparshëm.

Zbulimet shkencore mundësuan ndryshime



thelbësore në teknikë dhe në ekonomi si dhe tërësisht i ndryshuan pikëpamjet politike, bindjet fetare, artet dhe filozofinë. Këto zbulime praktikisht nuk e lanë të njëjtë asnjë

veprimtari njerëzor, dhe pikërisht për këtë është i madh numri i shkencëtarëve dhe zbuluesve që merituan vendin e tyre në këtë vepër.

Njutni si shkencëtar brilant dhe personalitet më me ndikim në zhvillimin e mendimit shkencor, me plotë të drejtë meriton vendin kulmor apo pranë vetë kulmit të çdo klasifikimi të personaliteteve më me ndikim në botë. Isak Njutni vdiq në vitin 1727 dhe u varros në Manastirin ministror me çka edhe u bë shkencëtari i parë që u nderua me një respekt të këtillë.

Shëndeti Oral

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PRISHJEN E DHËMBËVE

Dhëmbët luajnë rol të rëndësishëm tek njeriu. Përveç copëtimit të ushqimit, ato na sigurojnë një buzëqeshje të bukur, ndërsa dëmtimi i tyre sjell probleme të mëdha. Sipas statistikave, rreth 90% e shqiptarëve vuajnë nga sëmundjet e gojës dhe një pjesë e madhe i dedikohet mungesës së kujdesit për shëndetin oral.

Më poshtë do të gjeni disa fakte të rëndësishme lidhur me dhëmbët, si dhe kuriozitete të ndryshme që do t'ju bëjnë të jeni më të kujdesshëm ju vetë, por edhe familjarët tuaj në lidhje me dhëmbët.

A e dini se...

Sëmundjet e gojës ndikojnë në cilësinë e jetës së njeriut. Larja e dhëmbëve duhet të fillojë menjëherë pas daljes së dhëmbit të



parë të qumështit.

Pastat e dhëmbëve kanë në përbërje disa substanca që kanë rolin e tyre specifik.

Numri i baktereve në gojë mund të jetë më i madh se popullsia e botës. Era e keqe e gojës mund të jetë shenjë e disa sëmundjeve. Higjiena e gojës është shumë e rëndësishme, sidomos gjatë shtatzënisë. Një person i rritur ka 32 dhëmbë që do të thotë 160 sipërfaqe për t'u pastruar.

Cilët janë disa nga faktorët që ndikojnë në prishjen e dhëmbëve?

Sipas stomatologëve disa nga faktorët që ndikojnë në sëmundjet e dhëmbëve janë: mungesa e kujdesit, konsumimi i duhanit dhe ëmbëlsirave, kequshqyerja etj.

Për të pasur dhëmbë sa më të shëndetshëm duhet bërë kujdes edhe me ato ushqime, të cilat përmbajnë një sasi të madhe sheqeri, duke favorizuar në këtë mënyrë prishjen e dhëmbëve. Ëmbëlsirat nuk janë të vetmet ushqime që nxisin formimin e acideve dhe kavitateve.

Shumë ushqime që njerëzit i konsiderojnë të shëndetshme, si: *lëngjet e frutave, pijet energjike, frutat e thata dhe patatinat e llojeve të ndryshme, përmbajnë sasi të lartë të sheqernave të cilat nxisin kariesin dentar.* Gjithashtu edhe pijet freskuese mund të dëmtojnë dhëmbët tuaj.

Megjithëse pijet dietetike që përmbajnë sheqerna artificiale, ato mund të jenë të dëmshme për dhëmbët. Këto pije përmbajnë acide të cilat ndikojnë në tretjen e smaltit të dhëmbëve, duke nxitur hiper

ndjeshmërinë dhe krijimin e kavitateve.

Çfarë problemesh mund të shkaktojnë dhëmbët e prishur?

Shumë njerëz mendojnë se dhëmbët eprishur janë normalë dhe nuk krijojnë probleme shëndetësore. Ky fakt nuk është i vërtetë. Dhëmbët e prishur mund të shkaktojnë disa probleme si: – *Erë të keqe.* – *Ngjyrosje të dhëmbëve.* – *Mbindjeshmëri dhe dhembje.* – *Vështirësi në ushqyerje.* – *Infeksione të dhëmbëve.*

Sipas stomatologëve disa shenja të dhëmbëve të prishur janë: shije e keqe në gojë, mishra të dhëmbëve të enjtur ose të skuqur, gjakosja nga mishrat e dhëmbëve, dhëmbë që lëvizin, dhembje gjatë përtypjes, gurëza në sipërfaqen e dhëmbëve.

Nëse keni ndonjë nga këto shenja, drejtohuni menjëherë te mjeku stomatolog.

Federata Shqiptare e Stomatologëve rekomandon shtim të kujdesit ndaj higjienës së gojës, për të evituar prekjen nga këto sëmundje.

Përse është e rëndësishme larja e dhëmbëve?

Gjatë natës sasia e pështymës ulet, duke lënë dhëmbët tuaj më pak të mbrojtur nga acidet bakterore. Për këtë arsye larja e dhëmbëve me furçë dhe përdorimi i fillit dentar në mbrëmje është shumë e rëndësishme.

Larja e dhëmbëve duhet të zgjasë 2–3 minuta, 2 herë në ditë.

Përdorni një furçë me qime të buta dhe përdorni të paktën një herë në ditë fillin dentar. Përdorni shpëlarës goje të fluorizuar, përpara periudhës së gjumit.

Pas kësaj procedure përdorni shpëlarës goje të fluorizuar (pyeteni dentistin tuaj). Nuk rekomandohet të ushqeheni pas kësaj procedure. Nëse ndiqni këshillat e mësipërme, ju do të zvogëloni në mënyrë të konsiderueshme rrezikun e kavitetëve dentare.

Cila është mënyra më e mirë për mirëmbajtjen e higjienës së gojës?

Mënyra më e mirë për mirëmbajtjen e higjienës së gojës është larja e dhëmbëve çdo ditë, pas vakteve kryesore të ushqimit ose të paktën 2 herë në ditë, në mëngjes dhe në darkë me furçë dhe pastë dhëmbësh, ndërrimi i shpeshtë i furçës së dhëmbëve, si dhe kontrolli çdo 6 muaj te dentisti.

Dentistët rekomandojnë që një furçë dhëmbësh të ndërrohet mesatarisht çdo 3 muaj. Shpëlarja e gojës me ujë pas vakteve ka pak efekt mbi acidet bakterore, megjithëse mund të ndihmojë në eliminimin e mbeturinave ushqimore.

Çfarë është dita botërore e shëndetit të gojës?

Dita Botërore e Shëndetit të Gojës e vendosur nga Federata Dentare Botërore (FDI), organizohet çdo vit më datë 20 mars.

Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin si dhe të tregojë rëndësinë e madhe që ka shëndeti oral në shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien.


Higjiena e mirë e gojës është shumë e rëndësishme, pasi ajo favorizon një shëndet të mirë.

Fillimisht Federata Dentare Botërore në Kongresin Botëror Dentar (AWDC) të mbajtur në vitin 2007 në Dubai, vendosi datën 12 shtator dhe deri në fund të vitit 2012 kjo datë njihet si Dita Botërore e Shëndetit të Gojës. Këtë vit Federata Dentare Botërore vendosi ndryshimin e kësaj date, duke përcaktuar datën 20 mars.

Mesazhi i këtij viti ishte “Dita Botërore e Shëndetit Oral 2014, të promovojmë buzëqeshje të shëndetshme”.

Përpjekjet tona do të jenë në mbrojtjen e dhëmbëve të popullsisë në mbarë botën, nga fëmijëria në moshën e rritur. Sipas Shoqatës së Stomatologëve Shqiptarë, sëmundjet e gojës janë më të përhapurat dhe prekin rreth 90% të popullsisë.

Ato kanë një impakt domethënës në shëndetin e përgjithshëm të çdo individit.



Vetëm 60% e popullsisë, akses në kujdesin oral?

60-90% e nxënësve në gjithë botën vuajnë nga kariesi dentar. Incidenca e kancerit oral shkon nga 1 deri në 10 raste për 100.000 njerëz në shumicën e vendeve. Dhembja e dhëmbit është një ndër arsyt kryesore për mungesat në shkollë të nxënësve në shumë vende.


Konsumi i lartë i sheqerit është faktori kryesor i cili mund të sjellë prishjen e dhëmbëve dhe diabetin. Rreth 80% e vdekjeve për shkak të diabetit ndodhin në vendet me të ardhura të mesme dhe të ulëta.

Në vendet e zhvilluara barra e sëmundjeve orale është në rënie, ndërsa komplikacionet janë më të zakonshme, sidomos te pjesa më e moshuar e popullsisë.

Faktorët kryesorë të rrezikut, si përdorimi i duhanit, pasiviteti fizik dhe një dietë e varfër në yndyrë, kripë dhe sheqer, ul ndjeshëm rrezikun për t'u prekur nga sëmundje të ndryshme të gojës.

Risku për t'u prekur nga kanceri oral është 15 herë më i lartë kur kombinohen bashkë dy faktorët kryesorë të riskut, **duhani dhe alkooli**. 90 % e popullsisë së botës do të vuajnë të paktën një herë nga një sëmundje në gojë në jetën e tyre, duke filluar nga kariesi, sëmundjet periodontale, që çojnë në prishjen e dhëmbëve dhe kancerit të gojës.

Cila është sëmundja kryesore që prek dhëmbët tanë?



Sëmundja kryesore që prek dhëmbët tanë është kariesi, i cili është një infeksion që shkaktohet nga mikrobet që gjenden në hapësirën e gojës.

Kariesi dentar është një sëmundje komplekse që shkaktohet nga bakterie dhe mund të lidhet me faktorë të rëndësishëm si;

- **Konsumimi i ushqimeve dhe pijeve.**
- **Larja e dhëmbëve dhe përdorimi i fillit dentar.**
- **Vullneti juaj për të mbajtur dhëmbët e shëndetshëm. Bakteri kryesor përgjegjës për prishjen e dhëmbëve është Streptokoku Mutans.**

Faktorët kryesorë që ndikojnë në shumimin e këtij bakteri dhe që përcaktojnë prishjen e dhëmbëve janë:

- 1. Dieta juaj.**
 - 2. Sasia e fluorit në sipërfaqet e dhëmbëve.**
- Disa rregulla për një shëndet oral sa më të mirë**



1. Mbani një dietë të shëndetshme dhe zgjidhni ushqime nga grupet ushqimore si: Bukë, drithëra, fruta, perime, mish, peshk, qumësht, djath, kos.
2. Përdorni ujë pas ushqimit.
3. Mos konsumoni ushqime të thata dhe me shumë sheqer.
4. Lani dy herë në ditë dhëmbët me pastë me përmbajtje fluori.
5. Përdorni floss dentar (fije dentare) për heqjen e mbeturinave ushqimore mes dhëmbëve.
6. Reduktoni shpeshtësinë e marrjes së karbohidrateve (sheqernave) gjatë ditës.
7. Përdorni furçën e dhëmbëve 3 herë në ditë me pastë të fluorizuar.
8. Bëni kontrole periodike te dentisti.
9. Ndërroni furçën e dhëmbëve çdo 6 muaj.

Natyra dhe fuqia e paragjykimit

PARAGJYKIMET DHE STEREOTIPET

Paragjykimi, stereotipi, racizmi dhe seksizmi janë situata ku përshkruhet një vlerësim negativ të një grupi dhe i pjesëtarëve të tij individual që është thelbi i paragjykimit. Paragjykimi është vlerësim - gjykim negativ apo pozitiv i një individi apo më shumë individësh

duke i identifikuar ata me një grup të caktuar pa i analizuar karakteristikat e veçanta. Pra, paragjykimet qenkan qëndrime apo bindje ndaj një grupi të caktuar. Dy paragjykimet më të përhapura janë:

ai racor dhe seksual. Paragjykimi racor- Në thelbin e botës , çdo racë përbën një pakicë. Për një biolog molekular , ngjyra e lëkurës është një karakteristikë e parëndësishme njerëzore e kontrolluar nga një dallim i vogël gjenetik mes racave ku natyra nuk i ndan racat në kategori të përcaktuara rreptësisht. Jemi pra ne ose ai dhe jo natyra që e quan një person si afro-amerikan.

Disa fëmijëve zezak në vitet '40 kur i ipeshin për të zgjedhur mes kukullave të bardha dhe të zeza ata zgjidhnin të zezat por në vitet e '70 ata i zgjidhnin të bardhat ku me kalimin e kohës nisi të zhduket paragjykimi racor duke i parë të bardhët dhe të zinjët si të barabartë në tipare të tilla si zgjuarësi, përtaci dhe varësi. Problemet që lidhen me marrëdhëniet intime ndërracore preken ende nga paragjykimi.

Në një anketë kombëtare të amerikanëve ,75% thanë se do të blinin gjëra në një dyqan të drejtuar nga homoseksualët por vetëm 39% e individëve do të shkonin për vizitë tek një doktor homoseksual. Dankan (1976) u paraqiti studentëve disa filmime ku paraqitej një burrë i bardhë duke e përplasur në tokë një burrë të

zi apo me ngjyrë .

Vetëm 13% e studentëve e quante këtë aspekt dhunë duke e justifikuar përplasjen si "shaka" ose "dramatizim"

Por kjo gjë nuk thuhej kur ndodhte e kundërta kur një burrë i zi e

përplaste një burrë të bardhë dhe në këtë rast 73% e studentëve thanë se burri i zi përdori dhunë ndaj burrit të bardhë, pra opinion u ndryshua nga "shakaja" në "dhunë" Mendimi Kritik- shembuj të tillë kemi shumë në Kosovë përgjatë viteve të pas luftës (pa elaboruar periudhat e para luftes se fundit) që Serbët gjithmonë shumë bukur i elaborojnë dhe i justifikojnë dëmet e tyre ndaj popullit Shqipëtar. Sot çdo veprim që bie në kundërshtim me normat , ligjet etj...dhe çdo dhunë e servuar nga ata tek opinion ndërkombëtar ka peshë më të vogël ose imtësohet sesa nga ana Shqipëtarëve kur veprojnë një gjë të tillë të quajtur "dhunë ose kërcënim" ose kundërshtim ndaj Serbëve apo politikave të tyre, do të tingëllonte me jehonë të madhe ndërkombëtare.



Si pasojë, personalitet e tona ende po ballafaqohen me gjykata dhe pasojat e luftës së fundit duke dhënë llogari nga natyra e pergjithshme e hamendesimeve apo paragjykimeve para dhe gjatw periudhës së luftes kurse për gjenocidet e Serbëve ende gjykatat janë në procedura të stërgjatura ne tere Ballkanin. Në botë, komuniteti Shqipëtar deri ne vitet e “90 janë identifikuar me paragjykimin se nëse i ke 5-7 fëmijë je Shqipëtar.Pra, me këtë fakt ne këto paragjykime i ndjejmë dhe veprojmë ashtu. Stereotipet-janë besime , pergjithësime ndaj një grup njerëzish dhe mund të jenë të vërteta dhe të pavërteta.

Stereotipet gjinore- Tre shkencëtarë të

Universitetit të

Miçiganit u

treguan

studentëve disa

foto të një grupi

punues me femra

dhe meshkuj

secili prej

burrave të

paraqitur në

pikturë mori më

tepër vota se 3



gra të marra së bashku dhe ky stereotip i burrave si udhëheçës nuk është vetëm mendim i burrave por edhe mendimi nga vetë gratë pjesmarrëse në hulumtim.

Nga hulumtime të shumta del se njerëzit nuk i përgjigjen grave me emocione negative shembull siç bëjnë me disa grupe të tjera si karshi zezakëve homove etj etj, dhe këtë Igli (1994) e quan mrekullueshmëri të gruas sepse gratë ata i përceptojnë si të ndjeshme të dashura dhe që vijnë në ndihmë më shumë sesa burrat dhe se puna e tyre dita ditës po vlerësohet më shumë.

Pra, a e ka përmbushur misionin e saj lëvizja feministe?Ashtu si me paragjykimin racor , paragjykimi flagrant gjinor po vdes, por prirjet

e fshehura ende jetojnë. Mendimi Kritik-Gruaja edhe ndërkombëtarisht është parë si krijesë e dobët dhe inferiore duke u bazuar në të dhënat që e dallojnë nga mashkulli siç janë : Feja ku e sheh gruan nën mburojën e intelektualizmit dhe moralit mashkullor; shumë pak pozicione drejtuese mbulohen nga femrat, pagat janë gjithnjë më të ulëta se tek meshkujt, bile thuhet se një edukatore fëmijësh paguhet më pak sesa një mashkull që punon në mirëmbajtje të mbeturinave dhe pasuria e tyre është në raport me mashkullin 1/100. Gratë e Shqiptarëve me traditë për dekata të tëra kanë qenë amvise me pa mundësi shkollimi dhe tregimi të aftësive dhe kapaciteteve intelektuale.

Por ,koha e pasluftës solli benefitet duke u praktikuar me pune /shkollim dhe duke dëshmuar vehten me mirëkuptim nga bota mashkullore me Kanun...

Paragjykimet gjithashtu mund të shfaqen aty ku e presim më pak.Shkencëtarët theksojnë se njerëzit e përceptojnë paragjykimin dhe diskriminimin kur e parashikojnë atë si të bardhët ndaj të zinjëve , burrat ndaj grave,dhe të rinjtë ndaj të vjetërve. Në të tilla raste dyshimet e tona vërtetohen kur diskriminon femra femrën, të rinjtë nënvleresojne te moshuarit apo dhe femijet etj etj. Pavarësisht nivelit të lartë apo dhe të ulët të paragjykimit individi ka prirje për të frenuar mendimet dhe ndjenjat paragjyquese. Pra, është si të thyesh një zakon të keq kur përpiqemi të frenojmë mendimet e padëshiruara si për ushqimin, për intimitetin me mikeshën e një miku, ato gjyquese për një grup tjetër dhe ato mendime

gjithnjë refuzojnë të largohen. Ka disa teori lidhur me shkaqet e paragjyimit e ato mbështeten me teoritë e mëdha të njohura konjitive, psikodinamike, situative dhe historiko-kulturore. Trajtimi historik, social e kulturor është mjaftë i rëndësishëm ku historikisht është parë se gratë nuk janë të përshtatshme për vozitje të makinave gjë që tani del se shumë gra ngasin veturën por pak janë taksiste dhe kamioniste dhe për këtë arsye këto dukuri quhen edhe si paragjyime historike.

Diskriminimi-zakonisht i atribuohet minoriteteve ku si pasojë nis në hështje dhe përfundon në dhunë. Vëmendja më e madhe ndaj minoriteteve për t'u u paragjyuar është në momentet e zhvillimit urbanistik të hovshëm, në konkurrencën e punës ku ekonomia pëson rënie, në politike ku gratë me më pak vota se meshkujt e kanë të drejtën për asamble, si dhe për teritore ku janë mëse të njohura luftërat që shkakun gjithmonë na del Femra!

Trajtimi Psikodinamik- zakonisht njerëzit kur janë të frustruar pamundësinë e realizimit të qëllimit të tyre e zhvendosin tek personat më të dobët se vet.

Kjo ndodh edhe ndaj minoriteteve, edhe ndaj familjarëve të ngushtë ku thuhet se personat më paragjykues janë ata me personalitet autoritar. Pra, këta persona kanë qenë shumë udhëheqës, shumë baballarë dhe nëna që me ndëshkime fizike, kërcënime e ndëshkojnë me rreptësi mosbindjen e fëmijës ku më vonë pasojat janë tejet evidente tek fëmiju që e


kanalizon energjinë gjate zhvillimit te tij tek grupet më të dobëta ne shoqeri.

Trajtimet Konjitive- Thirrja dhe nxitja janë metoda tejet të vjetëra por me efekt pozitiv ku konsiston në vënien në dukje të vlerave të grupeve të paragjykuara.



Një shembull konkret është Martin Luter Kingu ku në vitin '63 me rreth 200 mijë njerëz treguan vlerën dhe drejtësinë morale të ndalimit të paragjyimeve e diskriminimit. Strategjia e kësaj metode synon të bindë për drejtësinë morale, lirisë dhe demokracisë së individëve duke mos u paragjyuar individit në bazë të përkatësisë etnike apo racore. Propaganda - apelet për ti dhënë fund paragjyimeve duke sjellur shtrembërim faktesh, maskime etj sjell në ndryshim të paragjyimit pozitiv ose negativ. Pra, paragjykimet dhe stereotipet qenkan bindje, besime krahas grupeve të ndryshme shoqërore duke i përfshirë edhe ato shëndetësore që I kemi ndaj dikujt që vuan me dëmtime intelektual apo edhe fizike.

Por fakte të tjera sjellin se pikërisht këta njerëz janë tejet të sukseshëm.

POEZI**Migjeni**

MIGJENI (1911-1938)

"KANGA QE S'KUPTOHET"

Melodisë kombëtare

U vodh kanga nga zemra e kombit,
shpërtheu në vaj të dikuem mjerimit,
këndoi ujen e së bijës, këndoi ujen e të
birit,
qau jetën e thyeme nga rrufe e fatit,
i mbyti në lotë shpirtët që ndjejnë dhimbë
për të ngratit.

Kangë a vaj? Çëje? Thuejma, zemër
kombi!

Zemër që ke vuetun, që ende po vuen...
Kangë a vaj? Çë je? Çë në ty po vluen?
Mallkimi ndaj fatet që ditët t'i helmuen,
që dëshirat e jetës të gjitha t'i gozhduen?

Oh -jo! Kangajote asht shprehje e
dhimbsun
e njëjetese që dergjet e dergjet
dhe tu' e dergjë ndoshta do hesht e
molisun...

Bardhyl Londo**"DEMOKRATET POPULISTE"**

Fryjne ererat. Perjet kane fryre keshtu.
Ku mbaron valle muzika? Ku fillon
zhurma?
Ne kryqezim te koherave, nje pikepyetje e
madhe
pergjjon e
ngaterruar
ku mbaron populli, ku fillon turma?

Ja, dolen populistet demokrate,
dallge ku perzihet uji dhe shkuma.
Populli rri serioz, i heshtur, i matur,
Shakara pa kripe mblacit turma

Dhe nisin tiradat, nisin zhargonet,
burokracia eshte si lopa, demokracia si
vetura.
Populli ul koken poshte i skuqur nga turpi,
"I madh", "i madh", cirret turma.

Fryjne erera. Mirefryfshi erera!
Kush ka veshe e dallon muziken nga
zhurma.
Koha ime, beju sa me pare popull,
larg, koha ime, larg nga turma.

POEZI**Sabri Hamiti****"KURR MË"**

E di: Kamy të donte shumë, e desha
Kamynë.

Ti mik i llogarive të pastra si loti,
banor i Tunelit, që jetën e përbiron tinëz
shpirtkëputur në mes të Trimave e
Varrtarëve

me pishë në dorë duke përmbysur terrin
zbret shkallë shkallë siç Zbritet në Ferr
shenjon të humburit numëron deri në
nëntë mijë

e thur nëpërmjet dhembjesh librin Kurr
më,

a e di: jetën e jeton secili veç e veç
deri në mbarimin e saj të pa marrë me
mend,

nënat sillen në rreth në Shesh të Fitores
shenjat e bijëve i mbajnë përmbi zemra
e fotoset kraheqafe vetëm për të
dëshmuar

se jeta ka qenë aty pranë e nuk është më
ato nuk do të lexojnë kurr librin Kurr më
se njohin vetëm jetën që jetohet në vetmi
duke i rrjetuar kujtimet me lotët në varg,

a e di: plaga sa një shpellë e zezë
po hyn në zemër e në bark të kujtesës,
më thuaj sa shigjeta kishe në zemër vetë
kur zbritte shkallëve nga libri në jetë?

O miku im i mikut tim të panjohur!

Esad Mekuli**"Popullit Tim"**

Deshta, shum' kam dasht-dishrue
që me këng të trimnoj, me fjalen tënde të
ndrydhun

të ngrej fuqitë prej gjumit...

Këndova (dhe kur m'ishte ndalue)
se liria do të vinte edhe për ty, të
përbuzun.

Këndova mbi ditët fatlume që do të
lindshin, pa dhun,
n'agimin e lirisë për ty me popujt këtu e
ngjeti,

mbi forc të bashkimit mbarë:
mbi vrullin tand të mëshehun

-unë, biri yt dhe-poeti.

Po! N'errsinën e shtypjes së randë sa
shkambi,

ndëgjova thirrjet që të bana me dal n'dritë-
pse për liri-me tjerë

ke dhanë dhe ti

djers e gjak si etnit.

Kam dhanë, i dashtun...Dhe sot, në liri-
kur thembra e gjaksorit s'na shkel dhe
dora pa

pranga mbeti,

me ty këndoju mbi fuqinë e ngjadhun nën
yllin që na pri'

-unë, biri yt besnik dhe-poeti.

ORIGJINA E MUZIKËS GEGE


Pasardhëse e kulturës muzikore të ilirëve të lashtë dhe të arbërve mesjetarë, muzika tradicionale shqiptare, në ditët tona, mrekullisht, shfaqet plot origjinalitet, individualitet, papërsëritshmëri. Po ashtu, ajo vjen tërë shkëlqim, bukuri, harlisje. Sidoqoftë, për kohën e lindjes së saj, nuk mund të jepet asnjë datë e caktuar. Në të vërtetë, një datë e tillë nuk ekziston. Përsa i takon origjinës, kohëlindjes, moshës, mendoj se, dialektet themelore të muzikës tradicionale shqiptare—dialekti muzikor geg, dialekti muzikor tosk, dialekti muzikor lab, dialekti muzikor qytetar—duhen parë thjesht si forma të ndërgjegjes artistike muzikore, të cilat lindën gradualisht si bashkëudhëtare të jetës së kombit shqiptar, ashtu sikurse ndodhi edhe në jetën e kombeve, popujve, grupeve të tjerë etnikë. Si muzika gege, ashtu edhe muzika toske; si muzika labe, ashtu edhe muzika qytetare, historikisht, që të gjitha, lindën, u rritën, u zhvilluan dhe u kristalizuan në vite, dhjetëvjeçarë e shekuj, nga vetë populli shqiptar.

Duke meditar mbi origjinën, kohëlindjen, moshën e muzikës tradicionale shqiptare, disa çështje etnomuzikologjike që do të kërkonin shqyrtim, ndoshta do të mund të formuloheshin në këtë mënyrë:

Përse vallë muzika gege dhe një pjesë e muzikës qytetare (grupimi muzikor qytetar *një-zërësh*) përbëhen nga një linjë melodike, përsa i takon strukturës së përgjithshme, kurse muzika toske, muzika labe dhe një pjesë e muzikës qytetare (grupimi muzikor qytetar *shumë-zërësh*) përbëhen, në shumicën e rasteve, nga dy, tri, ose katër linja melodike, përsa i takon strukturës së përgjithshme? Ose, rrjedhimisht:

Përse vallë muzika gege dhe një pjesë e muzikës qytetare (grupimi muzikor qytetar *një-zërësh*) interpretohen zakonisht nga një njeri i vetëm, individualisht, solistikisht, kurse muzika toske, muzika labe dhe një pjesë e muzikës qytetare (grupimi muzikor qytetar *shumë-zërësh*) interpretohen zakonisht nga shumë njerëz, kolektivisht, në grup?

Ka mundësi që një dukuri e tillë—struktura e përgjithshme e dyfishtë e muzikës tradicionale shqiptare: prania e një muzike një-zërëshe në Gegëri dhe e një muzike shumë-zërëshe në



Toskëri—të lidhet me jetën, kulturën, mënyrën e jetesës së kombit shqiptar. Siç ka vërejtur gjuhëtari, filologu, studiuesi i madh shqiptar, Eqrem Çabej (1908-1980), në Gegëri, shqiptarët, tradicionalisht, kanë jetuar nëpër kulla të vetmuara, larg njëra-tjetrës. Ndërkohë, në Toskëri, shqiptarët, tradicionalisht, kanë jetuar nëpër shtëpi të afërta njëra me tjetrën (Çabej 1939:50-7). Kështu, përsa i takon thelbit të jetës shoqërore, nocioni *fshat geg* ndryshon në krahasim me nocionin *fshat tosk*.

Ndoshta edhe për shkak të mënyrave të ndryshme të jetesës, gegët krijuan një muzikë një-zërëshe, kurse toskët—një muzikë shumë-zërëshe. Rrjedhimisht, të parët këndojnë e interpretojnë veç e veç, kurse të dytët—këndojnë e interpretojnë së bashku. Sidoqoftë, çështja e strukturës së përgjithshme të dyfishtë të muzikës tradicionale shqiptare—prania e një muzike një-zërëshe në Gegëri dhe e një muzike shumë-zërëshe në Toskëri—mbetet e hapur për hulumtime të mëtejshme.

Artdashës të caktuar, ndonjëherë, si rastësisht, priren që të ngrej në lart në mënyrë të njëanshme vlerat estetike të muzikës tradicionale të krahinave të tyre etnografike. Por, parimisht, muzika gege e muzika toske,

muzika labe e muzika qytetare, ashtu sikurse edhe stilet muzikorë përfaqësues të tyre, janë, që të gjitha, njësoj të barabarta, përsa u takon bukurisë e vlerave estetike. Parapëlqimet subjektive të dëgjuesve për muzikën tradicionale të krahinave të tyre etnografike, parapëlqime të cilat s'ka arsye përse të mos ekzistojnë, asnjëherë nuk mund të merren si kriter objektiv vlerësimi.

Në pamje të parë, vëmendje zgjon sidomos fakti se, muzika tradicionale shqiptare, ruan një strukturë të përgjithshme të dyfishtë: një-zërëshe e shumë-zërëshe. Ndërsa në Gegëri ajo është kryesisht me një linjë melodike, në Toskëri shfaqet kryesisht me shumë

linja melodike. Kështu, dialekti muzikor geg dhe një pjesë e dialektit muzikor qytetar (grupimi muzikor qytetar *një-zërësh*) janë me një linjë melodike, kurse dialekti muzikor tosk, dialekti muzikor lab dhe një pjesë e dialektit muzikor qytetar (grupimi muzikor qytetar *shumë-zërësh*) shfaqen zakonisht me shumë linja melodike. Në vitin 1938, studiuesi i mirënjohur italian, Lorenzo Tardo (1883-1967), i cili i kushtoi një pjesë të madhe të veprimtarisë së tij kërkimoro-shkencore hulumtimit të dorëshkrimeve muzikore bizantine që ndodhen në Grottaferrata (Itali), u shpreh se, muzika tradicionale shqiptare, përfaqëson një kulturë muzikore parabizantine. Duke karakterizuar natyrën e përgjithshme të muzikës tradicionale të shqiptarëve të emigruar në Itali, pas vdekjes së heroit kombëtar shqiptar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu (1405-1468) dhe rënies së Kalasë së Krujës në duart e Perandorisë Otomane të udhëhequr nga turqit, ai shkruan:

“Shqiptarët, që, duke e urreyer robërinë myslimane, e linin truallin atëror, nuk suallën me vete modën e fundit muzikore të Kostandinapolit, as artin e ditur e të mënçur të protopsalltëve të stërvitur, por një traditë krahinore malore dhe arkaike, një traditë që ishte mbajtur në 400-ën dhe 500-ën, por që, në të vërtetë, shkon më larg” (Tardo

1938:111). Origjina, kohëindja, mosha e zhanreve një-zërësh të muzikës tradicionale gegë, si: nina-nana ose ninulla, vajtimi ose gjama, kënga maje-krahi ose kushtruese, ballada, eposi heroik legjendar, eposi heroik historik, etj., është, pa dyshim, tepër e lashtë. Lejomëni të ndalem disi konkretisht në tiparet themelorë, lëndoro-substancialë e strukturoro-formalë, të tyre.

Nina-nana ose ninulla

Ky zhanër shquhet nga një radhë tiparësh lëndoro-substancialë e strukturoro-formalë të veçantë, si: përmbajtja thellësisht lirike, melodika e ndjeshme recitative, sistemi modal/tonal diatonik i gjymtë, metrika/ritmika

gjysmë ose krejtësisht e lirë, karakteri *a cappella*, etj. Tipare të tillë dëshmojnë arkaizëm. Pra, lashtësia shprehet qartë përmes vetë strukturës modale/tonale të nina-nanës.


Vajtimi ose gjama

Eshtë interesante të shënohet se, vajtimi ose gjama, ndonëse nga pikëpamja e përmbajtjes ndryshon rrënjësisht me nina-nanën ose ninullën, në plan strukturoro-formal, shquhet nga tipare të përafërta, në mos të njëjta, me të. Tipare themelorë të vajtimit ose gjamës, si: melodika e ndjeshme recitative, sistemi modal/tonal diatonik i gjymtë, metrika/ritmika gjysmë ose krejtësisht e lirë, karakteri *a cappella*, etj., në mënyrë aksiomatike, nxjerrin në pah lashtësinë e këtij zhanri.

Kënga maje-krahi ose kushtruese

Ky zhanër shquhet nga tipare të përafërt lëndoro-substancialë e strukturoro-formalë me vajtimin ose gjamën, si: përmbajtja thellësisht epike, forma tepër lakonike, melodika e ndjeshme recitative, sistemi modal/tonal diatonik i gjymtë, metrika/ritmika gjysmë ose krejtësisht e lirë, karakteri *a cappella*, mënyra karakteristike e interpretimit, vetë funksioni i posaçëm shoqëror i saj në jetën e malësorit geg, etj. Kështu, sërish lashtësia shprehet qartë përmes vetë strukturës modale/tonale të këngës maje-krahi.

Eposi heroik legjendar



Përsa i takon muzikës së eposit heroik legjendar, nga pikëpamja e origjinës, mendoj se, ajo duhet të ketë bërë jetë qysh para daljes së këtij zhanri, si një traditë artistike, e cila plotësonite nevojat shpirtërore të malësorit geg, në bashkëjetesë me zhanre të tjerë, para-eposikë. Me dukjen e eposit legjendar në botën arbërore, ajo nisi të hyjë në lidhje edhe me të. Kjo lloj muzike iu përshtat eposit legjendar, pak a shumë, ashtu sikurse më vonë iu përshtat eposit historik. Natyrisht, bashkëjetesa me njërin ose tjetrin zhanër letrar dhe kalimi nga njëra epokë historike në tjetrën, parakuptojnë ndryshime lëndoro-substanciale e strukturoro-formale të muzikës shoqëruese, por, në përgjithësi, ndryshime e modifikime të tilla kanë qenë të pjesshme. Tiparet strukturoro-formalë të muzikës së eposit heroik legjendar i japin asaj një përfytyrë origjinale, individuale, të papërsëritshme. Midis tyre, lejomeni të ve në dukje tipare, si: shtrirja modale/tonale në kuartë, kuintë ose sekstë; shkallët e gjymta diatonike të llojeve të vjetër dorianë e frigjianë, që formohen nga katër, pesë ose gjashtë tinguj të ndryshëm; fillimet më shumë në gradën e pestë (mi) dhe mbarimet zakonisht në gradën e parë (La); roli i veçantë i gradës së pestë në ndryshimin, pasurimin dhe zhvillimin melodiko-modal; formimi në përgjithësi nga intervale të vogël (primë, sekondë e vogël, sekondë e madhe, tercë e vogël, etj.); intervali melodik karakteristik i sekondës së vogël, i cili merr pjesë gjallërisht në ndërtimin e frazave muzikore; valëzimet e tingujve, si rregull, nga lart-poshtë, duke ndjekur shpesh kritere sekuenciale; parapëlqimi më tepër i lëvizjeve graduale, etj. Shkallët diatonike të muzikës së eposit heroik legjendar pasqyrojnë një kohë të hershme krijimi, e cila s'mund të lidhet domosdoshmërisht me periudhën e futjes së diatonikës në praktikën muzikore botërore (viti 1500 Para Erës Sonë), por, gjithsesi me një epokë tepër të lashtë: ajo duhet që t'u takojë shekujve të Mesjetës (afërsisht, periudha midis shekullit V dhe shekullit XV të Erës Sonë), kur, krahas pentatonikës, diatonika ishte gjinia modale/tonale mbizotëruese në muzikën tradicionale botërore. Pra, pikëpamja aksiomatike mbi lashtësinë e muzikës së eposit heroik legjendar mbështetet materialisht, në radhë të parë, prej ndërtimit modal/tonal të saj.

Po kështu, karakteri recitativ, tregimtar, folës, duke qenë një tipar themelor dallues i muzikës së eposit heroik legjendar, në të njëjtën kohë, mbetet një tregues i pakundërshtueshëm i lashtësisë së saj. Duhet marrë me mend se, mbarë arti muzikor tradicional botëror, në fillimet e veta, ka qenë dalluar nga nota të ndjeshme recitative, dhe, pastaj, gradualisht, fitoi nota ariozë, nën veprimin e kushteve të caktuar ekonomikë, shoqërorë, kulturorë, artistikë, etj. Për këtë arsye, nuk është e rastit që, gjini e zhanre të tillë folklorikë, si: nina-nana ose ninulla, vajtimi ose gjama, kënga maje-krahi ose kushtuese, ballada, kënga rituale, vallja rituale, etj., lashtësia e të cilave, duke qenë se është e mirënjohur, s'ka nevojë që të argumentohet, nga pikëpamja lëndoro-strukturoro, shquhen pikërisht nga nota të ndjeshme recitative, deklamative, folëse. Përmes të njëjtit proces duket se ka kaluar edhe muzika e eposit heroik legjendar shqiptar.



Eposi heroik historik

Në të vërtetë, muzika e eposi heroik historik ka një shtrat të përbashkët melodiko-modal me muzikën e eposit heroik legjendar. Fakti që, këngët epike legjendare, lindën historikisht disi më parë ose shumë më parë sesa këngët epike historike, nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm. Sidoqoftë, muzika e eposit heroik historik fiton edhe tipare të veçanta. Një shkak kryesor që ndikon në këtë mes, mendoj se është numri i madh i instrumenteve muzikorë shoqërues. Tashmë përcjellja instrumentore e këngëve nuk bëhet me anë të një instrumenti të vetëm të familjes kordofone, siç është lahuta, por me anë të një radhë instrumentesh të familjeve të ndryshme (bilbil, fyell, curle, çifteli, sharki, lahutë, lauri, dajre, lodër, etj.). Siç u vërejt, nga pikëpamja e origjinës, muzika e eposit legjendar dhe ajo e eposit historik, që të dyja, duhet të kenë ekzistuar në bashkëjetesë me zhanre të tjerë, para-eposikë.

ARTI I FOTOGRAFIMIT

Dikur për të dalë në fotografi duhej një ritual i tërë, ndërsa sot nuk ka nevojë as për fotograf. Një histori e shkurtër e tranzicionit të fotografisë shqiptare, nga fotoja bardhezi të fotoja me ngjyra, nga statizmi në studio te jeta dhe portreti në lëvizje. Profesionistët tregojnë këtë epokë ndryshimi Studiot e dikurshme të shërbimit fotografik, tani kanë mbetur vetëm nëpër kujtimet e njerëzve. “Qesh pak, shiko këtu...” dhe shkrap, blici bombardonte me dritë fytyrat, ndërsa një mori llampash të forta ndriçonin një faqe muri me një beze të vizatuar. Ishin skena të stisura, sfonde që shumëkush i ka ende bardhezi në albumet familjare. Breza të tërë shqiptarësh, që pozuan përpara atyre peisazheve të bëra nga ndonjë qejfli vizatimi, me bojëra vaji, me nxitim dhe pa shije, tani buzëqeshin dhe risjellin në mend atë kohë. Ishte një kohë që mbeti në fotografi.



Njerëz statikë, me buzëqeshje të mbërthyer, me sy që rrudheshin zorshëm në cepa, pa asnjë lloj grimë në fytyrë, kanë mbetur përgjithmonë aty. Ndërsa fotografia ka filluar të bëhet ndryshe, ashtu si jeta. Dikur me mik mund të gjeje një fotograf për ditën e dasmës. Ndërsa sot, rrallë gjen familje që të mos ketë një aparat fotografik për të regjistruar çastet e kujtimeve më të paharruara. Fotot me ngjyra tani janë një gjë e zakonshme për këdo. Por dikur, në vitet '60, '70, vetëm udhëheqësit dhe familjet e tyre fotografoheshin me filma me ngjyra. Ishin shumë të kushtueshëm dhe nuk lejohej që të përdreshin, as në shtyp. Një laborator i veçantë i fakultetit të inxhinierisë shërbente edhe si vendi ku laheshin fotot e udhëheqjes. Njerëz të talentuar, që

zgjidheshin nga fotografët e shtypit, ishin shpesh ata që realizonin foto familjare të ish njerëzve të diktaturës. Se ç'lidhje patën këta të fundit me ish udhëheqësit, kjo mbetet ende e çuditshme. Disa ruajnë ende nosltalgji për ato shërbime, disa të tjerë nuk duan ta kujtojnë atë kohë. Edhe pse në çdo rast secili përpiquej të bënte më të mirën e mundshme, në një vështrim të shpejtë, fotografia ishte një zanat dhe rrallëherë u këqyr si art. Ndërsa fotografia artistike qëndronte akoma më larg, nuk mund të arrihej. Në koleksionet e revistave të kohës së monizmit, gjithkush mund të shohë njerëzit e punës duke pozuar pranë tornove, pranë stallave, në galeri minierash, në

hekurudha.

Gjithmonë ka diçka të panatyrshme në ato portrete që duhet të tregojnë modelet e njerëzve të rinj, të përmbytur nga ideologjia. Dhe pikërisht kjo përpjekje përt të

paraqitur heronjtë e rinj, ngecte përpara filmit. Foto statike, pa lëvizje, pa komunikim, që të bëjnë të mendosh edhe tani për atë kohë frustruese. Disa nga autorët e atyre fotove pohojnë se ishte epokë e artë për profesionin. Kishin mjaft kohë për të realizuar fotot dhe nuk ekzistonte ngutja që është sot. Ndërsa disa të tjerë pohojnë se fotografia ekzistonte si një punë shërbimesh të komunales së dikurshme. Askush nuk kujtohej për të si për një art dhe askush nuk i kushtoi vëmendjen që meritonte.

Amatorët dhe profesionistët

Çfarë e bën artistike një fotografi? Nëse një fotograf profesionist fotografon të njëjtin objekt që fotografon edhe një person i zakonshëm, ku qëndron ndryshimi? Kjo është pyetja që i mundon gjatë

kureshtarët e fotografisë. Para pak kohësh fotografia ka reshtur së këqyruri si një formë midis teknikës dhe artit. Ajo është pranuar si lloj arti, ndërsa teknika ka përparuar në mënyrë marramendëse. Sot në Shqipëri mbi 80% e popullsisë ka një aparat fotografik që e përdor për dokumentimin e ngjarjeve familjare. Ndërsa në morinë e gazetave dhe revistave që dalin çdo ditë në treg, mund të shohësh fare mirë ndryshimin e cilësisë së fotografisë, edhe jo më larg se me 5 vjet më parë. Duket sikur fotografia po nxiton të bëhet shprehëse. Përditë e më shumë ajo po konkurron shkrimet dhe është duke folur drejtpërdrejt me publikun, pa nevojën e fjalëve. Megjithatë, në morinë e shfaqjeve të saj, cila është fotografia artistike?

Ata që janë marrë me fotografinë mendojnë se vërtet nuk ka një përcaktim të ngurtë se çfarë është kjo foto. Por Albes Fusha, pedagog fotografie në Akademinë e Arteve thotë: Foton artistike e dallon forma ose koncepti. Kjo e dallon një foto për nevoja dokumentimi të një gëzimi ose ngjarje familjare dhe kërkesave të një artisti. Artisti ka ose ngacmim estetik, ose ngacmim konceptual. Fotoja artistike është foto me kërkim më shumë se sa dokumentimi, për shembull “Unë dhe ti pëprara bustit të Skënderbeut”. Fotografia duhet të reflektojë një kulturë, korrente me fotografinë botërore. Në fund të fundit, fotoja artistike karakterizohet nga po të njëjtat kërkesa si artet e tjera.

Nëse do të bënim një klasifikim për ta kuptuar më mirë fotografinë, profesionistët janë të vetmit që na orientojnë. Albes Fusha pohon se dy janë shtyllat e fotografisë. Fotoja dokument dhe fotoja artistike. Në foton dokument përfshihen fotoja e gazetave, fotoja familjare, foto e kohës, foto e zbulimeve shkencore, e evenimenteve. Ndërsa po kështu mund të bëjmë edhe dallimin mes fotografëve reporterë dhe fotografëve artistë. Deri nga vitet '70 fotoja në Shqipëri notonte në ujërat e të fiksuarit të objektit. Por më pas gjithçka ndryshoi. Rruga që kishte bërë fotografia në vend që nga viti 1858 deri afër fundit të shekullit të njëzetë, numëronte mjaft mjeshtrë dhe

prurje. Mikel Kodheli, Marubi; Kolë Idromeno, Ymer Bali, Mandi Koci, Jani Ristani, Mihal Popi, Ali Baku, Niko Stefani, Misto Cici, Petro Dhimitri e mjaft të tjerë po pasoheshin. Disa nga familjet e njohura të fotografisë ishin aktive për dekada me radhë në pasurimin e fototekës shqiptare. Familje në kryeqytet si Kallfat, Veselët, Kumët po e transmetonin zanatin te brezat e rinj. Por gjithmonë ka një dallim midis zanatit dhe artit, thotë Albes Fusha, i biri i mjeshtrit të fotografisë Shqiptare Besim Fushes. Shumë abuzohet me cilësorin artistik. Të zotërosh shumë mirë një mjeshtri dhe të jesh artist, këto janë dy gjëra të ndryshme, thotë ai, duke theksuar që artizanti s'është pjesë e artit.

Fotoja me ngjyra

Petrit Kumi, mjeshtrë i fotografisë, Artist i Merituar, tregon se si u aplikua për herë të parë fotoja me ngjyra. Ai tregon se gjatë kohës kur punonte në revistën “Ylli”, në vitet e miqësisë shqiptaro- kineze, u krijua mundësia e një specializimi të tij dhe të një fotoreporterit nga Agjencia Telegrafike Shqiptare, Niko Stefani. Deri atëherë Pertef Sinani ishte mjeshtri i vetëm që ngjyroste foto bardhezi.



Fotot e kopertinave të revistave dhe të gjitha fotot e tjera të rëndësishme kalonin nga dora e tij.

Bënte çudira. Asokohe eksperimentuaesi më i madh në këtë fushe ishte Jani Ristani. Megjithatë, kinezët ishin të avancuar. Unë ndenja 6 muaj në Kinë për të mësuar foton me ngjyra. Kishte probleme me mënyrën se si të mësoinin, sepse ata e fillonin gjithçka nga e para, nuk merrnin parasyh që ti ishe fotograf, që e njihje teknikën. Të trajnonin për shembull për probleme të realizmit

socialist në fotografi. Kjo ishte pjesa e mërzitshme, “kineze” e çështjes. Por gjithsesi ishte një eksperiencë pozitive. Pas kthimit tonë nga Kina, puna e Pertefit ra, u duk që perëndoi koha e ngjyrosjes. Dhe të mendosh se ajo që bënte ai ishte një art më vete, sepse ngjyrote me bojë vaji. Futja e fotove me ngjyra i lehtësoi më shumë fotografët, sepse një pjesë të madhe të meritës e morën ngjyrat. Por gjithsesi mjeshtrit duken në foton bardhezi. Jo më kot edhe sot e kësaj dite kjo lloj fotografie është e lakmuar.

Misset dhe deputët, foto artistike, apo foto dokument?

Shpesh kundrimi i objekteve të bukura natyrore të dokumentuara në foto na bën të themi: Ja kjo është një foto artistike. Por në fakt ka një dallim mes fotos artistike dhe fotos tjetër, edhe kur ajo është bërë mbi të njëjtin objekt. Për shembull një miss, është një vajzë e bukur. Nëse ajo fotografohet thjesht drejtpërdrejt nga një person që disponon një



aparat fotografik dhe nëse fotografohet nga një mjeshër, sigurisht që do të kemi rezultate të ndryshme. Petrit Kumi pohon se me këto lloj fotografish, ku objekti është vetvetiu diçka e bukur, është duke u abuzuar mjaft kohët e fundit. Modelet, misset dhe mjaft kategori të tjera, fotografohen në mënyra të çuditshme dhe fotot e bëra serviren si foto artistike. Por nuk është foto artistike një foto ku gjithçka rregullohet me ca pozime, me ca lëvizje, ku nuk mund të shohesh asgjë më përtej se ajo që duket.

Albes Fusha pohon se fotot e këtij tipi janë vetëm foto dokument.

Ndërsa i pyetur për fotot e posterave elektorale, Petrit Kumi pohon se në mjaft raste ai habitet nga mënyra se si janë realizuar aq keq disa foto. Në shumë raste kandidatët për deputetë u drejtohen studiove

dhe kërkojnë të realizojnë posterat. Por shpesh asgjë nuk arrin të realizohet në funksion të komunikimit me publikun.

Petrit Kumi: Fotografia nuk mësohet në shkollë

Unë i qëndroj idesë se fotoja kronikale është ajo që i jep më shumë shanse kujtdo, për të arritur në fotot artistike të papërsëritshme Kam mbaruar liceun për pikturë. Më 1956 punoja si piktur reviste. Një fotograf, Sulejman Kelmendi, u bë shkak që unë të lija në plan të dytë pikturën dhe të jepesha pas fotografisë. Në vitin 1960 isha përfundimisht fotograf dhe punoja në Agjencinë Telegrafike Shqiptare. Isha personi që fotografoi Hrushovin në vizitën e tij në Shqipëri. Ishte grupi i fotografëve Kallfa-Pici dhe Refik Veseli që e dokumentuan gjithashtu këtë vizitë. Një vit

më vonë u largova nga agjencia dhe shkova në revistën “Ylli”, ku qëndrova deri në 1985. Që nga viti 1992 e deri tani punoj për vete. Është një biznes familjar, ku nuk janë punësuar

vetëm persona të familjes. Megjithatë, nuk e lë pas dore interesin për foton artistike. Në ata mijëra filma që vijnë të lahen në Fotokumi, unë gjej mjaft fotografi që ndonjëherë ua kalojnë profesionistëve. Nuk do të jetë e largët dita kur do të kem gati një ekspozitë me klientët amatorë më të mirë. Për mua fotografia nuk mësohet në shkollë. Ajo është një lloj arti dhe si çdo art, ka talentin kryesor.

Megjithatë, nëse flasim në pikëpamje teknike, mendoj se mund të mësohen mjaft gjëra. Por sot në Shqipëri nuk ka shkollë të mirëfilltë dhe për fat të keq, edhe konkursi i fotografisë, “Marubi”, nuk ka vlerën e një ballafaqimi të vërtetë dhe të një vendi ku konkurrojnë vërtet njerëzit që merren me artin e fotografisë. Unë i qëndroj idesë se fotoja kronikale është ajo që i jep më shumë

shanse kujtdo, për të arritur në fotot artistike të papërsëritshme. Janë momente mjaft të vogla, ku një fotoreporter mund të arrijë të realizojë një foto artistike, nëse ai e ka instiktin e artistit. Personalisht mendoj se ATSH ka qenë një shkollë madhe e fotografisë. Gjithashtu mendoj se kjo agjenci disponon arkivin më të madh shqiptar të fotografisë. Padyshim ajo ishte epiendra e zhvillimit të fotografisë shqiptare pas luftës së dytë botërore. Mjaft nga mjeshtrat e fotografisë së asaj kohe nuk përfillen sot, por unë mendoj se ata kanë kontribuar në mënyrë të jashtëzakonshme.

Albes Fusha:

Shtypi përmirësoi shijet e publikut
Mendoj se në kohën e monizmit fotografia anonte nga dokumentimi, ndërsa sot tenton nga arti, nga lirshmëria e krijimit artistik. Ndoshta periudha e punës në shtyp ishte ajo që më bëri t'i hyja fotografisë. Por mendoj se kishte disa premisa që më drejtuan nga fotografia. Tradita familjare ishte njëra, formimi artistik ishte tjetra. Unë kam kryer Akademinë e Arteve për pikurë. Pas mbarimit të akademisë pata një periudhë qëndrimi në SHBA.

Bashkë me dy miq të mi kishim shkuar atje për një ekspozitë pikturë. Vendosi ta zgjasim kohën e qëndrimit. Ka qenë kjo periudhë kur mundëm të shihnim galeritë e Nju Jorkut dhe të perceptonim edhe fotografinë, midis të tjerash. Rikthimi im në vitin 1997 më pozicionoi si fotoreporter shtypi. Ishte thjesht një tendencë punësimi, e cila më tërhoqi gjithmonë e më shumë. Më pas më 1999 bëra një specializim në Austri dhe pas asaj kohe pata një ofertë për të punuar si pedagog në Akademinë e Arteve, ku punoj edhe tani.

Vitet e fundit studimi i fotografisë në këtë akademi dhe në fakultetin e Gazetarisë po tenton drejt zgjerimit. Mundet që në të ardhmen, pse jo, të ketë një degë më vete

për fotografinë në Akademinë e Arteve. Për sa i përket tendencës së fotografisë në kohë, mendoj se në kohën e monizmit fotografia anonte nga dokumentimi, ndërsa sot tenton nga arti, nga lirshmëria e krijimit artistik. Sot fotografët kanë mundësinë e komunikimit. Personalisht besoj që “Marubi” është një konkurs i vlefshëm, i hapur për debatin, për shkëmbimin e eksperiencave, është një kuvend i mirë i fotografisë shqiptare sot. Sigurisht, asgjë nuk është e përsosur, po tendenca është pozitive në këtë aktivitet. Qoftë edhe duke mbyllur pak syrin për mangësitë që mund të ketë, “Marubi” është një konkurs që ka vlera të mëdha edhe në pikëpamje të dokumentimit. Në të marrin pjesë edhe shumë prej amatorëve të avancuar të fotografisë dokumentare. Mendoj se angazhimi më i madh me fotografinë në vitet e fundit e ka rritur edhe shijen e publikut. Kjo është bërë në mënyrë instiktive, thjesht nga ballafaqimi i përditshëm me cilësinë e fotografisë që vjen në rritje, sidomos në shtyp.

Roland Tasho:

Të dokumentosh tranzicionin

Gjatë lëvizjeve demokratike, ishte pikërisht profesioni ai që më vuri në qendër të ngjarjeve mua dhe aparatit tim. Kam dokumentuar gjithçka.

Lidhja ime me fotografinë ka filluar në

mënyrë të rastësishme. Ishte viti 1982. Isha shumë i ri, sapo kisha mbaruar ushtrinë. Kisha pasur një mundësi për të shkuar në shkollë oficerësh, por nuk shkova. Kështu që vendosa të hyja në punë. Në lagje, siç ishte organizimi i atëhershëm, kishte një zyrë për punën. Një nëpunës atje më regjistroi emrin dhe sa herë që shkoja e pyesja më thoshte “Prit, e di që je i paduruar, por po mendoj për ty”.



Shkolla dhe fëmijët

PËRSE FËMIJËT REFUZOJNË SHKOLLËN



Dy janë proceset që karakterizojnë sjelljen refuzuese të fëmijës ndaj shkollës: e para ka të bëjë me një lloj "mohimi", pra nënkupton mosdëshirën për të mos vajtur në shkollë dhe për t'u marrë me gjëra të tjera që i pëlqejnë, dhe e dyta, frika ndaj shkollës, e cila përmban në vetvete dimensione psikologjike.

Jo pak herë prindërit janë të detyruar të ushtrojnë presion, sidomos tek fëmijët e shkollës fillore dhe nëntëvjeçare, që ata të ndjekin rregullisht mësimet.

Madje është dashur jo rrallë herë që ata t'i ndjekin nga pas për t'u siguruar se vërtet janë ulur në bankat e shkollës.

Por në asnjë mënyrë prindërit nuk duhet të qetësohen kur i shohin ata të bindur dhe me kokën e ulur përpara mësueses. Përkundrazi, tek "protestat" e fëmijëve të tyre prindërit duhet të kërkojnë dhe zbulojnë arsyet e vërteta, me qëllim që të kenë nën kontroll të gjithë botën e tij emocionale dhe mendore.

Por përse refuzojnë fëmijët të shkojnë në shkollë?

Ndoshta këtë pyetje bëjnë vazhdimisht edhe prindërit që ndeshen me një problem të tillë, ndaj ky shkrim do të ishte me vlerë për ta...

Dy janë arsye serioze që duhet t'i shqetësojnë prindërit

Dy janë proceset që karakterizojnë sjelljen refuzuese të fëmijës ndaj shkollës: e para ka të bëjë me një lloj "*mohimi*", pra nënkupton mosdëshirën për të mos vajtur në shkollë dhe për t'u marrë me gjëra të tjera që i pëlqejnë, dhe e dyta, *frika ndaj shkollës*, e cila përmban në vetvete dimensione psikologjike.

Ndonëse specialistët nuk bëjnë shumë dallim midis këtyre dy proceseve, duhet pranuar se rasti i dytë është shumë më serioz dhe shpesh kërkon ndërhyrjen e psikologut.

Arsyeja më shqetësuese

Kjo mënyrë e fundit e sjelljes u karakterizua për herë të parë si e tillë (pra, frikë nga shkolla) nga Xhonsen dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët gjithashtu këmbëngulnin në veçimin dhe kategorizimin e saj të ndarë nga *“mohimi”* dhe mungesa në shkollë, gjë e cila, edhe më vonë, jo vetëm që u mbrojt por edhe u vërtetua nga shumë kërkues që u morën me këtë çështje.

Në studimet e tyre rreth mënyrës së sjelljes të fëmijës ndaj shkollës analistët e psikologjisë përdorin kufirin *“frikë shkollore”* për të përshkruar atë lloj frike që shkaktohet nga përplasje të brendshme dhe të jashtme të fëmijëve dhe shfaqet në një objekt asnjans sikurse shkolla, të cilën në vazhdim ata kërkojnë ta shmangin sistematikisht.

Por çështja nuk është kaq e thjeshtë sikurse duket në teori.

P.sh. po të mbështetmi në të dhënat e Ministrisë së Arsimit të Britaninë së Madhe, ku janë bërë edhe një sërë studimesh rreth kësaj teme, ekzistojnë të paktën shtatë kategori për të përshkruar mënyra të ndryshme sjelljeje ndaj shkollës: mungesa të paarsyeshme, mungesa të arsyeshme, mos dëshirë e brendshme, mungesa sistematike, mungesa periodike, largim nga shkolla, refuzim i shkollës ose frikë nga shkolla.

Konkretisht, kategoria e parë e mungesave të paarsyeshme, konsiderohet si mohim i shkollës për një periudhë të caktuar pa patur ndonjë arsye të saktë dhe mendohet se buron nga mënyra me të cilën është edukuar fëmija, të paktën në lidhje me arsimimin e tij.

Sikurse vihet re ndarjet e mungesave janë të tilla që të lihet të kuptohet se në një farë

masa *“fajtorë”* janë edhe prindërit, pavarësisht se mungesat mund të kategorizohen në mohim ose mosdëshirë.

Duke studiuar këtë fenomen më tepër nga pikëpamje klinike fare lehtë *“mohimi”* ose

largimi nga shkollë mund të konsiderohen si mënyra sjelljeje jo shoqërore, sikurse vjedhja ose tendenca që kanë disa fëmijë për të thënë vazhdimisht gënjeshtër.

Ky rezultat vërtetohet edhe nga studimi i njohur i Hersov, i cili zbuloi se nxënësit që mungojnë pa arsye nga shkolla, po të krahasohen me ata që kanë frikë nga shkolla, kanë më shumë mundësi për të shfaqur më vonë mënyra sjelljeje jo të mira si

rrugaçëria, tendenca për të thënë gënjeshtër, shkatërrime dhe mund të mbërrijnë deri në dyert e gjykatave.

Si arsye bazë e këmbënguljes së fëmijës për të munguar pa arsye nga shkolla zakonisht konsiderohet dëshira e tij për t’ju shmangur disa veprimtarive të caktuara ose personave në shkollë, por shumë herë edhe dëshira e tij për t’u marrë me veprimtari që i pëlqejnë (të cilat mund të jenë të ndaluara), por thjesht nuk bëjnë pjesë në programin shkollor.

Në këtë pikë vlen të theksojmë se sipas shumë psikologëve për fëmijë që janë marrë me këtë çështje për shumë vjet me radhë, largimi nga shkolla është diçka që fëmija e bën dhe kënaqet.

Nga ana tjetër refuzimi shkollor zakonisht përdoret, duke u kombinuar dhe ndërruar shpesh herë vende, me frikën shkollore, që konsiderohet si një lloj depresioni psikik i cili lidhet me ndonjë ankth të brendshëm, shqetësim që mund të shkaktohet nga ndryshim i situatave sikurse mungesa e



njërit prind ose e ndonjë vëllai apo ndryshimi i shpeshtë i shkollës etj.

Është karakteristike se vetë shërbimi i ministrisë së arsimit francez thekson, këtu e shumë vjet, se frika shkollore përbën problem të tipit klinik dhe në më të shumtën e rasteve trajtohet si një lloj depresioni dhe jo si largim apo mos dëshirë për shkollë.

Kur shfaqet frika shkollore

Lidhur me moshën në të cilën një fëmijë mund të shfaqë frikë shkollore, specialistët theksojnë (megjithëse nuk ekziston mendim plotësisht unik midis tyre) se është më e mundshme që kjo frikë të shfaqet zakonisht në nxënës të moshën 11 ose 12 -vjeçare dhe arrin deri në të 14-at.

Nga ana tjetër, shkolla “amerikane”, mbështet idenë se mosha më kritike për të shfaqur frikë shkollore është midis pesë dhe dhjetë vjetëve.

Në vija të përgjithshme, fëmijët me frikë shkollore paraqesin zakonisht dobësi serioze në marrjen e iniciativës, tregojnë më të mëdhenj se mosha e tyre,



vuajnë nga ndonjë pikëllim dhe mbajnë një qëndrim pa shprehje.

Faktorët shkaktarë

Gjithashtu, është me interes të theksojmë faktorët që çojnë në lindjen e një problemi të tillë, sidomos ato që kanë të bëjnë me familjen dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek të dy grupet e fëmijëve.

Është karakteristike përfundimi i studimit të Blagg, që lidhet me një nga faktorët, sikurse është niveli i papunësisë së prindërve.

Gjithashtu, për fëmijët që paraqesin frikë shkollore është vënë re se përveç faktit se vijnë nga familje të shtresës mesatare, shpesh iu duhet të përballojnë ankth të madh e shqetësim kur detyrohen të braktisin shtëpitë dhe prindërit e tyre.

Në fund, themi se duhet të jepet rëndësi kryesore tek familja dhe më pas në rolin e shkollës, si faktor që ndikon shumë herë në krijimin e problemit, përderisa studime të shumta kanë treguar se gati 50% e nxënësve evropianë shprehin ankth dhe shqetësim për disa anë të jetës së tyre në shkollë.

Fëmijët shpesh ngacmohen nga bashkëmoshatarët e tyre që ndihen të pasigurt dhe duan të bëjnë për të treguar që janë më të mirë.

Për këtë arsye është e rëndësishme që fëmijët të zhvillojnë besim të mjaftueshëm tek prindërit që mund të kenë komunikim të hapur me ta.

Prindërit që nga fëmijëria duhet t'i mësojnë fëmijëve vlerat reale sepse fëmijët fitojnë besimin dhe sigurinë nga identifikimi me prindërit. Në këtë formë fëmijët shumë lehtë do të

mund të adoptohen në vendet si “çerdhe” apo në parashkollorë.

BARCALETA

Nastradini në pemë

Nastradini kishte hipur mbi një pemë dhe po hante banane. Aty kalojnë shokët e tij - dhe fillojnë ta ngacmojnë.

- E di Nastradin, se majmunët kanë zbritur nga pemët shumë kohë më parë...

- Po, e shoh - ua kthen ai.



Nastradini Gjumash

Nastradin! - E shkundi nje nate gruaja Nastradinin.

-S'te vjen keq qe kam tere naten pa gjume duke tundur djalin qe qan? Tunde dhe ti njecike, se fundja, djali s'eshte vetem i imi, eshte edhe i yti.

-Ti tund tenden - i tha Nastradini - gjysmen time lere te qaj.

Nastradini dhe shkencetaret

Nastradini megjithese nuk dinte te shkruante dhe te lexonte merr pjese ne nje koference shkencore.

Nje shkencetar, qe ishte ulur aty afer Nastradinit, i bie ne sy sjellja e tij dhe me nje ton talles pyet:

-Cfare ndryshimi ka ndermjet teje dhe gomarit?

Nastradini ja kthen:

Ka vetem nje pellembe largesi...



BANANIA

Në Akshir shojin shumë rallë. Kështu një tregtar, që ka udhëtuar shumë, nuk habitet kur sheh Nastradinin që po ha një banane pa e qëruar.

Nastradin, i thotë ai me një ton miqësor, më lejo të të them, që para se të hash këtë frut shumë të shjshëm e që vjen nga vendet e largëta Afrikane, duhet të heqësh lekurën.

Shumë të faleminderit për këshillën, përgjigjet Nastradini duke u përtypur, por edi se aq mirësa ti ë'shtë një banane dhe nuk kam nevoj të shikoj se çka brenda.

